



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-53

PËR GJUE TINË

Kuvendi i Kosovës

Në mbështetje të Kreut 5.1. (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të dt. 15 maj 2001),

Me qëllim të rregullimit të menaxhimit të qëndrueshëm kultivimit, mbrojtjes dhe gjuetisë së kafshëve të egra,

Miraton:

LIGJIN PËR GJUE TINË

Kapitulli I: Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohet menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ruajtja e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtja adekuate e kafshëve të egra, sigurimi i mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të resurseve, nevoja për siguri dhe standardin e etikës së gjahtarëve.

Neni 3

Definicionet

Për qëllimet e këtij ligji, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

“**Kafshët e egra**” përfshinë kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultivim intensiv apo për shumim.

“**Gjuetia**” përfshin ndjekjen, plagosjen, vrasjen, ose zënien e kafshës, dhe çfarëdo përpjekje në këto aktivitete.

“**E drejta e gjahut**” është drejta që në sipërfaqen e caktuar të tokës apo ujit (në vazhdim tokës) të ndërmerr veprime dhe masa të kultivimit, mbrojtjes, shfrytëzimit të kafshës së egër dhe pjesëve të saj.

“**Zona**” sipërfaqja e gjerë në të cilën janë kushtet e njëjta ose të ngjashme (bujqësore, të pyjeve dhe zona të larta malore me mbi 1000 m lartësi mbidetare) për jetesë të kafshëve të egra.

“**Vend gjuetia**” sipërfaqe e caktuar e tokës e cila paraqet tërësi natyrore ku ekzistojnë kushte ekologjike dhe kushte tjera për kultivim, mbrojtje, gjueti dhe përdorim të kafshëve të egra.

“**Vendgjuetija e hapur**” sipërfaqja në të cilën është i mundur migrimi ditor dhe sezonal i kafshëve për gjueti.

“**Vendgjuetija e mbyllur**” sipërfaqja e rrethuar me pengesa natyrore ose artificiale që pengojnë apo dukshëm e kufizojnë lëvizjen e kafshëve të egra jashtë kësaj hapësire.

“**Ferma për kultivimin e kafshëve të egra**” sipërfaqja e rrethuar me gardh, më e madhe se 50 ha, e paraparë për kultivimi e kafshëve të egra.

“**Menaxhuesi i vendgjuetisë**” është person fizik ose juridik i cili është pronar ose e ka fituar të drejtën e menaxhimit të vend gjuetisë sipas procedurës së paraparë me këtë ligj.

“**Dhënia me qira e vendgjuetisë**” është dhënia në shfrytëzim e vend gjuetisë nëpërmes ofertës publike personave fizik apo juridik për afat deri në 10 vite.

“**Dhënia e vendgjuetisë në koncesion**” është e drejta e ushtrimit të veprimtarive ekonomike, me interes të përgjithshëm duke shfrytëzuar pasuritë natyrore, me pagesë personave fizik apo juridik, vendorë apo të huaj në kohëzgjatje deri në 30 vjet.

“**Plani menaxhues**” është dokument në bazë të cilit bëhet menaxhimi i kafshëve të egra dhe mjedisit për afat kohor prej 10 vitesh.

“**Plani vjetor i menaxhimit**” është dokument i bazuar në planin e menaxhimit i cili ka të bëjë me menaxhimin e gjuetisë gjatë një viti.

“**Sezoni i gjuetisë**” koha në të cilën është e lejuar gjuetia në lloje të caktuara të kafshëve për gjueti.

“**Ndalesa e gjuetisë**” koha në të cilën është e ndaluar gjuetia për lloje të caktuara të kafshëve për gjueti.

“**Kafshët për gjueti trofe**” - kafshët për gjueti ose pjesët e tyre të cilat ruhen dhe vlerësohen.

“**Trofetë kulminante**” trofeja e ndonjë kafshe të egër e vlerësuar me numër më të madh të poenave se trofeu me numër më të madh të poeneve të llojit të caktuar të kafshës së egër në Kosovë.

“**Gjahu grupore**” është gjah me asistentë dhe përdorim të zhurmës ose teknikave tjera për t’i shtyer dhe ekspozuar kafshët para gjahtarit.

“**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

“**Person**” nënkupton personat fizik ose juridik.

Neni 4
Lista e kafshëve të egra

Kafshë të egra sipas këtij ligji janë:

Dreri i rëndomtë –(Cervus elaphus L.)
Dreri lopatar - (dama dama L)
Kaprolli – (Capreolus capreolus L)
Dhia e egër – (Ripicarpa rupicarpa L)
Muflloni – (Ovis aries musimon Paall)
Derri i egër – (Sus scrofa L)
Ariu i murmë - (Ursus arctos L)
Vjedulla – (Meles meles L)
Lundërza – (Lutra lutra L)
Shqarthe i artë – (Martes martes L)
Shqarthe i bardhë – (Martes foina Ehr.)
Bukla e madhe – (Mustela erminea L)
Bukla e vogël – (Mustela nivalis L)
Qelbësi i zakonshëm – (Mustela putorius L)
Lepuri i zakonshëm – (Lepus europaeus Pall.)
Ketri – (Sciurus vulgaris L)
Gjeri i rëndomtë – (Myjoxsus glis L)
Miu bizam – (Ondatra zibethica)
Dhelpra – (Vulpes vulpes L)
Ujku – (Canis lupus L)
Çakalli – (Canis aureus L)
Macja e egër – (Felis silvestris Schr.)
Rrëqebulli – (Lynx lynx L)
Pula e egër e madhe –(Tetrao urogallus L)
Stërvinarja – (Tetrastes bonasiaL)
Fazani – (Phasianus sp. L)
Fëllënza gurore – (Alecoris graeca Meissn)
Fëllënza e fushës –(Perdix perdix L)
Shkurtëza – (Conturnix conturnix L)
Shaptorja malore -) Scolopax rusticola L)
Shaptorja e kënetës – (Gallinago gallinago
Shaptorja e livadheve – (Gllinago media)
Pëllumbi gungash -) Columba palumbus L)
Pëllumbi i zgavrave – (Columba oenas L.
Pëllumbi i zi – (Columba livio Gmelin
Turtullesha – (Streptopelia turtur L)
Kumria – (Streptopelia decaocta L)
Pate e përhimt – (Anser anser)
Pata e murritzit – (Anser fabalis Latham)
Pata Ballbardhë- (Anser alifrons)
Rosa shurdhake – (Anas platyrhynchos.L)
Rosa e përhimt – (Anas strepera)
Rosa – (Aythya fuligula)
Rosa bishtgërshtë – Anas acuta
Rosa sp. – (Anas querquedula)

Rosa shpatore – (Anas clypeata)
Rosa sp. – (Anas crecca)
Polaga – (Fulica atra L)
Kukuvajka e bardhë-(Cukulus conurus)
Huti veshor i pyjeve – (Asio otus)
Huti i maleve – (Strix aluco)
Sokoli pulngrënës – (Accipiter gentilis)
Krahëthata zogngrënëse (Accipiter nisus)
Orli – (Buteo buteo)
Petriti Celenger – (Falco tinnunculus)
Korbi io zi -)Corvus corone cornix L)
Sulkoka – (Corvus fragilegus L)
Korbi – (Corvus corax)
Stërçoka – (Coloeus monedula L)
Laraska – (Pica pica L)
Cota – (Garulus glandarius L)

Kapitulli II: Gjuetia

Neni 5

E drejta në gjueti

Të drejtën në gjueti e fiton:

1. Pronari, në vend gjuetinë e themeluar në pronën e tij private.
2. Personat tjerë juridik apo fizik me
 - a) marrjen e të drejtës së gjuetisë në vendgjueti me koncesion
 - b) marrjen me qira të vendgjuetisë.
3. Personat vendor dhe të huaj mund të fitojnë të drejtën e gjahut në vendgjueti në pronë publike me koncesion apo marrjen me qira sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjin për koncesionet.

Neni 6

Federata e Gjuetarëve të Kosovës

6.1. Menaxhuesit e vendgjuetive, gjahtarët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik të cilët merren me gjueti në territorin e Kosovës mund të bashkohen në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata).

6.2. Federata i përfaqëson brenda dhe jashtë anëtarët e vetë me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre përparimit, kultivimit, mbrojtjes, gjuajtjes dhe shfrytëzimit të kafshëve të egra, mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së vendbanimeve natyrore të kafshëve të egra, kultivimit të etikës së gjuetarit dhe traditave të gjuetisë dhe qëllimeve tjera që kanë bëjnë me gjuetinë.

6.3. Federata financohet nga kontributi i anëtarëve.

6.4. Funkcionet, detyrat, përgjegjësitë dhe veprimtaria e Federatës si dhe mënyra e anëtarësimit dhe vendosjes në Federatë, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrur nga Ministria dhe me Statutin e Federatës. Statuti i Federatës nuk mund të jetë në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura në bazë të tij.

Neni 7

Kufizimet e përgjithshme në gjueti

7.1. Për të marrë pjesë në gjueti rekreative ose komerciale, gjahtari duhet t'i plotësoj këto kushte:

- a) të gjuaj kafshën e gjahut gjatë sezonës së hapur, të shpallur nga Ministria
- b) të përdor armën e regjistruar sipas ligjit, dhe mos të përdor mjetet, metodat dhe teknikat e ndaluara të gjuetisë.
- c) të ketë kualifikim përkatës në pajtim me këtë ligj
- d) të gjuaj brenda venduetisë.
- c) të ketë lejen me shkrim nga menaxhuesi i vendgjuetisë.

7.2. Për të marrë pjesë në gjuetinë për qëllime speciale, gjahtari përveç që duhet të ketë leje për armë në pajtim me ligjet e zbatueshme për armët, duhet të plotësoj një nga kushtet e mëposhtme:

- a) të plotësoj kushtet për gjueti shkencore;
- b) të plotësoj kushtet për gjuajtjen e llojeve të kafshëve dëmtuese;
- c) të plotësoj kërkesat për reduktim
- d) të plotësoj kërkesat për veprim në raste emergjente.

Neni 8

Hapja e sezonit të gjuetisë

8.1. Personat mund të merren me gjueti rekreacionale ose komerciale vetëm brenda sezonës së hapur për gjueti.

8.2. Kohën e gjuetisë dhe hapjen e sezonit të gjuetisë së kafshëve të egra sipas llojit, gjinisë, moshës dhe gjendjes numerike e cakton Ministria me akt të veçantë nënligjor.

8.3. Ministria duhet të publikoj listën e sezonave të hapura të gjuetisë në Gazetën Zyrtare.

8.4. Lajmërimi për listën e sezonit të hapur të gjuetisë duhet të publikohet së paku shtatë ditë para fillimit të sezonit në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Kosovë edhe në së paku dy gazeta.

8.5. Sezonat e hapura sipas këtij neni vlejné deri në njoftimin tjetër ndërsa për lloje të caktuara mund të bëhen për çdo vit.

8.6. Gjatë caktimit të sezonit të gjuetisë nga ky nen, nuk lejohet gjuetia e kafshëve për gjah gjatë kohës së mbarësimit dhe gjatë shtegtimit pranverorë të tyre.

8.7. Nëse moti i keq, sëmundja, gjuetia e tepruar, ose rrethanat tjera zvogëlojnë popullacionin e llojeve të kafshëve të gjahut, Ministria mund të ndaloj ose shkurtoj sezonën e hapur.

Neni 9

Metodat, teknikat dhe mjetet e ndaluara të gjuetisë

9.1. Askush nuk ka të drejtë të vras ose zë kafshën e egër duke përdorur helm, përveç nëse helmi është i regjistruar për atë qëllim dhe përdoret sipas Ligjit për Pesticide.

9.2. Personi që përdor helm për vrasjen e kafshës së egër brenda vendgjuetisë, në rastet e lejuara me ndonjë ligj të veçantë, duhet së pari të informoj menaxhuesin e vendgjuetisë.

9.3. Gjatë gjuetisë rekreative ose komerciale, askush nuk ka të drejtë të vras ose zë kafshët e egra:

- a) gjatë vërshimeve, orteqeve të borës, akullit, zjarrit, ose kushteve tjera të jashtëzakonshme natyrore që vështirësojnë dukshëm ose e kufizojnë lëvizjen e kafshëve.
- b) duke përdorur mënyrën e vrasjes masive.
- c) duke përdorur eksplozivë, kurtha, gropa, gracka, ngjitës për shpezë, grepa, rrjeta, karrem të helmuar, ose mjete mashtruese.
- d) duke përdorur karrem të gjallë të verbuar ose sakatuar.
- e) duke përdorur kuaj, qerre, automjete, barka me motor, ose aeroplan për ndjekje.
- f) duke përdorur drita artificiale ose pasqyra ndriçuese.
- g) duke përdorur pajisje elektronike për të përmirësuar pamjen në dritë të dobët.
- h) duke përdorur pajisje për reprodukim të zërit.
- i) duke përdorur rrymën elektrike për të vlarë ose shtanguar.
- j) duke përdorur tym ose gaz që i shtyjnë kafshët të dalin nga vendet ku fshehën.

9.4. Ndalohet gjuajtja e kafshëve të egra gjatë natës duke filluar nga 30 minuta pas perëndimit të diellit gjer në 30 minuta para lindjes së diellit, përveç në rastet kur personi i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuar me këtë ligj, dhe ka edhe lejen e veçantë, me shkrim nga Inspektori i gjuetisë për të gjuajtur gjatë natës. Për gjuajtje gjatë natës informohet Shërbimi Policor i Kosovës së paku 24 orë para fillimit të gjuetisë.

9.5. Leja për gjuajtje gjatë natës përveç tjerash duhet të përmbajë kohën dhe vendin ku mund të gjuhet, llojin e kafshëve që mund të gjuhen, dhe emrat e personave që mund të marrin pjesë në gjueti të natës.

9.6. Askush nuk mund të përdor ndjekjen grupore për të vlarë ose zënë kafshët thundrore, përveç derrave të egër.

9.7. Personi mund të përdor qentë për ndjekjen e kafshës së plagosur, por nuk mund të lejoj qentë që të mundojnë ose sulmojnë kafshën.

9.8. Askush nuk mund të shkatërroj foletë, stroullat ose vezët e shpendëve të egra.

9.9. Ministria me akt nënligjor përcakton kërkesat shitesë ose ndalesat për gjuetinë e llojeve të caktuara.

Neni 10

Armët e lejuara për gjueti

10.1. Gjuajtja e kafshëve të egra lejohet vetëm duke përdorur armët dhe municionin e përshtatshëm për gjueti.

10.2. Kafshët e mëdha të gjahut lejohet të vriten me armë me vijaska duke përdorur municion të kalibrin dhe peshës së plumbit që i përshtatet fuqisë dhe rezistencës së

kafshës. Kafshët e mëdha të gjahut nuk lejohet të gjuhen me pushkë me tytë të lëmuar, përveç derrat të egër.

10.3. Shpezët dhe lepujt nuk lejohet të gjuhen me pushkë me vijaska dhe me pushkë gjysmë automatike e cila nuk është e reduktuar për pranimin të jo më shumë se dy fishekëve.

10.4. Armët dhe municioni i gjahut lejohen të përdoren vetëm po që se përdorimi i tyre nuk e rrezikon sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë.

10.5. Arma e gjahut nuk mund të bartet pa leje për bartje. Arma e gjahut nuk mund të përdoret jashtë vend gjuetisë, poligoneve për gjuajtje si dhe vendeve tjera të caktuara për ushtrime në gjuajtje.

10.6. Përdorimin e armëve dhe municionit të përshtatshëm për gjueti e cakton ministria me akt nënligjor.

Neni 11

Kualifikimi i gjahtarëve dhe vlerësuesve të Trofeve

11.1. Kafshën e egër lejohet ta gjuajë personi i cili është aftësuar për gjahtar gjegjësisht që e ka të dhënë provimin për gjahtarë, dhe leje me shkrim nga menaxhuesi i vendgjuetisë.

11.2. Provimin për gjahtar dhe për vlerësues të trofeve ipet në Federatë para komisionit të formuar nga Federata. Për dhënien e provimit për gjahtar Ministria mund të autorizoi ndonjë Institucion tjetër. Për provimin e dhënë lëshohet çertifikatë.

11.3. Programin e trajnimit dhe të provimit për gjahtar dhe vlerësues të trofeve i përcakton ministria. Ministria para aprovimit të programeve trajnuese dhe programit të provimeve nga ky nen konsultohet me Federatën.

11.4. Personat, të cilët gjatë shkollimit të tyre të drejtimit të pylltarisë, bujqësisë dhe biologjisë kanë mësuar lëndë nga gjuetia nuk janë të obliguar të japin provimin për gjuetarë.

11.5. Menaxhuesi i vendgjuetisë mund të lejojë gjuajtjen për qëllime turistike apo hulumtime shkencore edhe personave pa provim për gjuetarë sipas kushteve të përcaktuara me aktet e veta.

11.6. Gjahtari mund të kualifikohet për gjah në njërin nga këto mënyra:

- a) Gjahtari mund të kualifikohet si gjahtar i kualifikuar duke kaluar provimin standard të përcaktuar me programin e aprovuar nga Ministria.
- b) Gjahtari mund të kualifikohet si gjahtar praktikant duke gjuajtur vetëm nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të gjahtarit të kualifikuar gjatë pjesëmarrjes në programin trajnues për gjahtar, të aprovuar nga Ministria.
- c) Gjahtari mund të kualifikohet si gjahtar turist, i cili nuk është banor i Kosovës, i regjistruar si turist të menaxhuesi i vendgjuetisë dhe që gjuan nën mbikëqyrjen e gjuetarit të kualifikuar.

11.7. Federata e mbanë listën e gjahtarëve të kualifikuar sipas këtij Ligji.

11.8. Ministria me akt nënligjorë mund të përcaktoj:

- a) që gjahtarët kohë pas kohe të ripërtërijnë regjistrimet e tyre, duke ri testuar aftësitë e tyre fizike dhe mentale.
- b) të pranoj gjahtarë të kualifikuar të moshës mbi 65 vjeçare dhe mund të caktoj rregulla të veçanta që do të vlenin për ta.

11.9. Gjahtarët pajisen me kartelat identifikuese për gjahtarë të cilat i lëshon menaxhuesi i vendgjetisë.

11.10. Kartelat identifikuese lëshohen nga:

- a) i autorizuari për provimet për gjahtar- gjahtarë të kualifikuar.
- b) menaxhuesi i vendgjetisë- për gjahtarët praktikant dhe gjahtarët turist.

11.11. Gjahtarët mund të ngarkohen me një pagesë vjetore për të mbuluar shpenzimet e organizimit të provimeve të gjahtarëve, lëshimin e kartelave identifikuese, mirëmbajtjen e regjistrave dhe shërbime tjera të cilat caktohen nga ofruesi i shërbimeve.

Kapitulli III: Gjuetia për qëllime të veçanta

Neni 12

Gjuetia për qëllime shkencore

12.1. Gjahu për qëllime shkencore përfshinë gjahun ose zënien e kafshëve të egra për hulumtime shkencore, mësim universitar, përdorim në kopshte zoologjike, shumim të kafshëve për gjah, panairë kinologjike ose qëllime tjera.

12.2. Lejen për gjah për qëllime shkencore e lëshon Ministria.

12.3. Para marrjes së lejes për gjueti për qëllime shkencore nga paragrafi 2 i këtij neni , personi duhet të merr pëlqimin e menaxhuesit të vendgjetisë përkatësisht pronarit të tokës private, nëse gjuetia për qëllime shkencore bëhet në tokën private që nuk është e përfshirë në vendgjueti.

12.4. Leja duhet të përcakton kohën, vendin dhe metodën e gjahut të lejuar, llojet e kafshëve të gjahut për t'i gjuajtur, arsyeshmërinë e aktivitetit si dhe raportimin e numrit të kafshëve të marra.

12.5. Metoda e gjahut për qëllime shkencore mund të përfshijë çdo metode që Ministria konsideron humane dhe të arsyeshme.

Neni 13

Gjahu i kafshëve dëmtuese

13.1. Kur kafsha e egër shkakton dëme të përmasave të gjëra, rrezikon jetën e njerëzve apo pronën e tyre, ministria me akt nënligjor mund ta shpallë kafshën përkohësisht si dëmtues dhe të lejoj gjuajtjen e saj për kohë të caktuar.

13.2. Llojet e kafshëve të egra dëmtuese nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të gjuhen gjatë tërë vitit vetëm nga personat e kualifikuar për gjah sipas këtij ligji.

13.3. Personat që donë të vrasin kafshët e egra dëmtuese duhet paraprakisht të informojnë policinë për kohën, vendin dhe metodën e gjuetisë brenda 24 orëve.

13.4. Metoda e gjuetisë mund të përfshijë çdo metodë që Ministria i konsideron humane dhe të arsyeshme.

13.5. Për gjuajtjen e llojeve të kafshëve të egra dëmtuese në vendgjueti, personi duhet gjithashtu të ketë lejen nga menaxhuesi i vendgjuetisë.

13.6. Për gjuajtjen e llojeve të kafshëve të egra dëmtuese në tokën private e cila nuk është përfshi në vendgjueti, personi duhet gjithashtu të ketë lejen nga pronari i tokës.

13.7. Askush nuk mund të gjuaj llojet e kafshëve të egra dëmtuese në vendet e ndaluara për gjah sipas këtij ligji.

Neni 14 Gjahu reduktues

14.1. Reduktimi nënkupton gjahun e kafshëve të egra kur popullacioni i tyre nuk është në harmoni me ekuilibrin biologjik të vendgjuetisë ose kur ato i shkaktojnë dëme pronës për shkak të numrit të madh të tyre.

14.2. Kur menaxhuesi i vendgjuetisë paraqet evidencën e nevojave të reduktimit, Ministria mund të lejoj menaxhuesit të vendgjuetisë të organizoj dhe kryej reduktimin në vendgjuetin e tij.

14.3. Personat që marrin pjesë në gjueti reduktuese duhet jenë gjahtar të kualifikuar sipas këtij ligji.

14.4. Personat që marrin pjesë në gjuetinë reduktuese nuk mund të përdorin metodat e ndaluara të gjahut rekreativ ose komercial.

14.5. Ministria nuk lejon gjuetinë reduktuese që nuk është në harmoni me planet menaxhuese përfshirë planin menaxhues 10 vjeçar me kafshë të egra për Kosovën dhe planet operationale vjetore në fuqi në vendgjueti.

14.6. Para fillimit të reduktimit menaxhuesi i vendgjuetisë duhet ta informon policinë 24 orë përpara.

Neni 15 Vrasja emergjente e kafshës së egër

15.1. Në rastet kur kafsha e egër kërcënon dëmtimin e shpejtë dhe të rëndë të jetës së njerëzve, apo dëmtimin e shpejtë dhe të madh të pronës, mund të bëhet vrasja emergjente e tyre për të parandaluar rrezikun në jetën e njerëzve apo dëmin e pronës.

15.2. Personat që vrasin kafshët e egra gjatë rasteve të emergjencës duhet ta informojnë rastin në polici e cila e dërgon informatën Ministrisë dhe menaxhuesit të vendgjuetisë të afërt.

15.3. Personat që kanë vrarë apo lënduar kafshë të egra të trasha në aksident të komunikacionit, duhet të vejnë një shenjë në vendin ku ka ndodhë aksidenti dhe t'a informojnë policinë si dhe menaxhuesin e vendgjuetisë më të afërt.

15.4. Gjahtarët që plagosin kafshën e egër të trashë duhet të përcjellin gjurmët e kafshës së plagosur e nëse është e nevojshme të lajmërojnë menaxhuesin e vendgjuetisë më të afërt.

Kapitulli IV: Vendgjuetitë

Neni 16

Llojet e vendgjuetive

16.1. Për ushtrimin e veprimtarisë së gjuetisë, themelohen vendgjuetitë.

16.2. Vendgjuetitë themelohen varësisht nga lloji i kafshëve të egra të cilat natyrshëm jetojnë apo kryesisht kultivohen në një sipërfaqe të tokës, numrit të kafshëve të cilat sipas mundësive të vendgjuetive mund të kultivohen në atë sipërfaqe, destinimit të tyre dhe pronësisë së tokës.

16.3. Vendgjuetitë mund të themelohen si:

- a) vendgjueti të hapura,
- b) vendgjueti të mbyllura apo të rrethuara dhe
- c) vendgjueti për kultivimin e kafshëve të egra.

16.4. Sipas të drejtës së pronësisë vendgjuetitë janë:

- a) private
- b) të përbashkëta dhe
- c) me rëndësi të veçantë

Neni 17

Sipërfaqja minimale për themelimin e vendgjuetive

17.1. Vendgjuetitë e hapura nuk mund të jenë në sipërfaqe më të vogël se 1.000 ha.

17.2. Vendgjuetitë e mbyllura - të rrethuara nuk mund të jenë me sipërfaqe më të vogël se 500 ha.

17.3. Vendgjuetitë me destinim (rëndësi) të veçantë nuk mund të jenë sipërfaqe më të vogël se 2.000 ha.

17.4. Vendgjuetitë për kultivimin e kafshëve të egra përfshinë sipërfaqet në të cilat mund të kultivohen llojet e caktuara të kafshëve të egra për shtimin e numrit më të madh të kafshëve të shëndosha të destinuara për gjueti dhe reprodukim.

Neni 18

Themelimi i vendgjuetive private

18.1. Lejen për themelimin e vendgjuetive private e jep ministria me kërkesën e pronarëve të tokave private në të cilat themelohen vendgjuetitë private.

18.2. Ministria do ta aprovoj kërkesën për themelimin e vendgjuetive private nëse plotësohen kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura në bazë të tij.

18.3. Ministria duhet të informoj komunat në të cilat shtrihen vendgjuetitë e themeluara private.

18.4. Për plotësimin e kushteve të parapara për themelimin e një vendgjuetie private, pronarët privat mund të marrin me qira edhe tokë jo private e cila kufizohet me tokën në të cilën themelohet vendgjuetia private.

18.5. Për themelimin e vendgjuetisë private përveç kushteve tjera të parapara me këtë ligj, duhet të plotësohen edhe këto kushte:

- a) Të ekzistoj marrëveshja me shkrim e të gjithë pronarëve të tokave në të cilat themelohet vendgjuetija;
- b) Themelimi i vendgjuetisë të jetë në pajtim me planet ekzistuese hapësinore.
- c) Përdorimi i tokës për gjueti të mos paraqes kërcënim për shëndetin ose sigurinë publike.

Neni 19

Vendgjuetitë e përbashkëta

19.1. Vendgjuetitë e përbashkëta janë vendgjuetitë e themeluara në tokat në pronë publike dhe private e ku paraprakisht nuk janë themeluar vendgjuetitë private apo vendgjuetitë me rëndësi të veçantë.

19.2. Vendgjuetitë e përbashkëta i themelon Kuvendi Komunal në territorin e së cilës shtrihet sipërfaqja e tokës në të cilën themelohet vendgjuetija, me propozimin e organit komunal kompetent për punët e bujqësisë dhe pëlqimin paraprak të ministrisë.

19.3. Brenda territorit të një komune mund të themelohen një ose më shumë vendgjueti. Po qe se sipërfaqet e tokave në të cilat themelohet vendgjuetija gjendet në territorin e dy apo më shumë komunave, vendgjuetin e themelon komuna në të cilën gjendet pjesa më e madhe e vendgjuetisë, me propozimin e komisionit të përbashkët profesional dhe me pëlqimin paraprak të ministrisë.

19.4. Komuna duhet të siguroj se themelimi i vendgjuetisë është në pajtim me planet ekzistuese hapësinore.

Neni 20

Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë

20.1. Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë themelohen me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të kushteve jetësore për kafshët e mëdha të egra, llojet e rralla e të rrezikuara të kafshëve të egra dhe drejtimit të zhvillimit të popullacioneve të tyre në mjedisin ku ato jetojnë.

20.2. Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë themelohen nga ministria me akt të veçantë nënligjor pa marrë parasysh pronësinë e tokës në të cilën themelohen.

20.3. Ministria me rastin e themelimit të vendgjuetive nga ky nen, duhet të njoftoj komnatat, dhe pronarët privat të territorit në të cilin shtrihen vendgjuetitë.

20.4. Ministria duhet të siguroj se themelimi i vendgjuetive është në pajtim me planet ekzistuese hapësinore.

Neni 21

Rishikimi i kufinjëve administrativ

21.1. Në vendgjuetitë e reja që themelohen, nuk mund të përfshihen tokat nga vendgjuetitë e themeluara me këtë ligj, përveç nëse menaxhuesi dhe autoriteti themelues i vendgjuetisë ekzistuese pajtohen për dhënien e një pjese të tokës vendgjuetisë së re.

21.2. Nëse pronari dëshiron të shtoj ose zvogëloj sipërfaqen e tokës nga vendgjuetia private, duhet të ketë pëlqimin e Ministrisë dhe të dy të tretat e pronarëve të vendgjuetive private.

21.3. Brenda vendgjuetive me rëndësi të veçantë dhe vendgjuetive të përbashkëta, themeluesi mund të shtoj ose zvogëloj sipërfaqen e tokës nga vendgjuetitë sipas procedurave dhe standardeve të përcaktuara me këtë ligj për themelimin e vendgjuetive.

21.4. Nëse tokat bëhen të papërshtatshme për gjueti për shkak të ndërrimit të destinimit, themeluesi mund të zvogëloj sipërfaqen e tokës nga vendgjuetia e caktuar pa procedurë formale.

21.5. Kufijtë e vendgjuetive duhet sa më shumë që është e mundur të përcjellin kufijtë natyrorë të vendeve ku jetojnë llojet e caktuara të kafshëve të egra.

21.6. Vendgjuetia private humb statusin e vendgjuetisë nëse paraqitet njëra nga arsyet e mëposhtme:

- (a) nëse menaxhuesi nuk ka zhvilluar aktivitete menaxhuese në vendgjueti për dy vite të njëpasnjëshme.
- (b) nëse dy të tretat e pronarëve të tokave të vendgjuetisë private tërhiqen nga vendgjuetia.
- (c) për shkak të rishikimit të kufijve administrativ ose ndryshimit të përdorimit të tokës, Ministria konstaton se vendgjuetia nuk i plotëson më kushtet si që janë: sipërfaqja minimale, mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë publike.
- (d) Personi juridik që vepron si menaxhues i vendgjuetisë deklaron se ka falimentuar ose nuk ekziston më.

21.7. Vendgjuetia e rëndësisë së veçantë ose vendgjuetia e përbashkët do të humb statusin e vendgjuetisë nëse për shkak të ndryshimit të karakterit ose destinimit të tokës, sipërfaqja e vendgjuetisë zvogëlohet nën minimumin e përcaktuar me këtë ligj.

Neni 22 Zonat e mbrojtura

Nëse vendgjuetia përfshinë tokat në zonat e caktuara të mbrojtura, ato qeverisen sipas dispozitave të ligjit për themelimin e parqeve apo zonave të mbrojtura të natyrës dhe me atë ligj mund të kufizoj gjuetinë në ato toka.

Neni 23 Prona brenda vendgjuetive

23.1. Të gjithë pronarët e tokave brenda vendgjuetive duhet të ndërmarrin masa të nevojshme për parandalimin e dëmeve ndaj kafshëve të egra.

23.2. Personat që merren me bujqësi ose pylltari brenda vendgjuetive duhet të kenë kujdes gjatë përdorimit të preparateve kimike të ndryshme dhe gjatë korrjeve dhe kositjeve të minimizojnë dëmet ndaj kafshëve të egra.

Neni 24
Vendet e ndaluara për gjueti

24.1. Vendgjuetitë nuk përfshinë:

- a) Zonat e natyrës posaçërisht të mbrojtur në të cilat me aktin e shpalljes si zonë e mbrojtur apo ndonjë akt tjetër të veçantë është ndaluar gjuetia si : rezervati strikt i natyrës, parku nacional, monumenti i natyrës, zona menaxhuese e habitateve ose e llojeve të mbrojtura, peizazhi i mbrojtur, zona e mbrojtur e resurseve natyrore.
- b) Tokat brenda 300 metrave nga vendbanimet, rrugët kryesore publike, ndërtesat fetare, shkollat, dyqanet ose zyrët.
- c) Varrezat, aeroportet, bazat ushtarake dhe oborret e mbyllura.
- d) Fidanishtet, pemishtet, vreshtat dhe kopshtet të destinuara për prodhim intensiv në sipërfaqe deri në 100 ha nëse janë të rrethuara me rrethojë e cila e pengon migrimin natyror të kafshëve të egra.

24.2. Me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit më të suksesshëm të kafshëve të egra caktohen territore kultivuese. Madhësia e territoreve kultivuese sipas llojit të kafshëve të egra dhe mënyrës së menaxhimit të vendgjuetive që gjenden në këto territore përcaktohen nga ministria me akt të veçantë nënligjorë.

Neni 25
Kufijtë administrativ të vendgjuetisë

25.1. Në rast se nuk ekzistojnë kufijtë natyror si rrugët, hekurudhat, lumenjtë, liqejtë apo vija tjera ndarëse të kufirit, menaxhuesi i vendgjuetisë duhet të shënoj kufijtë administrativ të vendgjuetisë dhe duhet të mirëmbajë këto shenja.

25.2. Mënyrën e shënimit të kufijve të vendgjuetisë e përcakton Ministri me akt nënligjor.

25.3. Askush nuk mund të merr, dëmtoj, lëviz, ose shkatërroj shenjat e kufijve administrativ që vehen sipas këtij neni pa lejen e menaxhuesit të vendgjuetisë.

Neni 26
Menaxhimi i vendgjuetiëve private

26.1. Vendgjuetitë private menaxhohen nga themeluesit e vendgjuetive.

26.2. Vendgjuetitë private mund të jepen me qira dhe nënqira.

Neni 27
Dhënia e vendgjuetive në menaxhim

27.1. Vendgjuetitë e përbashkëta u jepen në menaxhim personave që i plotësojnë kushtet sipas këtij ligji përmes koncesionit apo dhënies me qira. Vendgjuetitë mund t'iu jepen në menaxhim personave fizik ose juridik.

27.2. Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës apo subjekti tjetër i autorizuar nga ministria.

27.3. Vendgjuetitë jepen në koncesion ose me qira përmes procedurës së tenderit i cili shpallet pas themelimit të vendgjuetive.

Neni 28

Dhënia e vendgjuetive në koncesion

28.1. E drejta në koncesion mund ti i pet personit fizik apo juridik, vendor apo të huaj në kohëzgjatje deri në 30 vjet. Ministria mundet me vendim të posaçëm të ndaloj të drejtën e dhënies në koncesion të sipërfaqeve të caktuar në të cilat është themeluar vendgjuetia me rëndësi të veçantë.

28.2. Nëse e drejta në koncesion jepet në zonat e mbrojtura në të cilat është e lejuar themelimi i vendgjuetive, koncesioni jepet me pëlqimin e subjektit që menaxhon me zonat e mbrojtura të natyrës sipas aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës.

28.3. Vendgjuetia e dhënë në menaxhim me koncesion nuk mund të jepet në nën koncesion.

Neni 29

29.1. Vendimin për dhënien e vendgjuetisë në koncesion e merr ministria në bazë të procedurës së tenderimit publik.

29.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni Ministria mundet që me kërkesën e qiramarrësit të vendgjuetisë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë, në bazë të mendimit të inspektionit kompetent, ta jap vendgjuetin në koncesion deri në njëzet vjet, me kushte të njëjta, nëse:

- a) në vendgjueti ka ndërtuar objekte të gjuetisë të cilat nuk mund të amortizohen brenda njëzet viteve.
- b) ka arrite gjendjen e përcaktuar numerike të kafshëve të trasha të egra si dreri, ariu, dhia e egër etj., dhe ka arritur rezultate të mira në ruajtjen dhe rritjen e tufave natyrore të kafshëve të egra.
- c) në periudhën e kaluar ka përfillë të gjitha dispozitat e planit të menaxhimit, i ka përmbushë të gjitha obligimet kontraktuese me kohë dhe ka respektuar dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.
- d) në periudhën e kaluar ka patur bashkëpunim të mirë me menaxhuesit e vendgjuetive për rreth dhe me shërbimin e inspektionit dhe nuk i janë shqiptuar masa ndëshkuese.
- e) me sukses ka zbatuar masat e mbrojtjes së kafshëve të egra nga gjuetia e kundërligjshme dhe sëmundjet dhe ka bashkëpunua në pengimin e gjuetisë së kundërligjshme.
- f) me sukses ka parandalua dëmet dhe evitua pasojat e dëmshme nga kafshët e egra në sipërfaqet bujqësore dhe pyjore.

29.3. Vendimin për shpalljen e tenderit publik për dhënien e vendgjuetisë në koncesion e bjen ministria.

29.4. Ofertuesi, ofertës për marrjen e vendgjuetisë në koncesion ia bashkëngjet dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij. Ofertuesi-koncesionari i cili është person juridik duhet të bashkangjes dëshminë se është i regjistruar për këtë veprimtari, ndërsa personi fizik, dëshminë se është i regjistruar në regjistrin e obliguesve të tatimit në fitim.

29.5. Procedura e tenderimit zhvillohet sipas Ligjit për Prokurimin Publik..

Neni 30

Shuma fillestare e kompensimit

30.1. Shuma fillestare e kompensimit për koncesionin e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 30% të vlerës së kafshëve të egra të gjuajtura në vitin e dhjetë të planit të menaxhimit të llogaritura sipas çmimit të tregut.

30.2. Në rastet kur nuk ekziston plani i menaxhimit shuma fillestare e kompensimit për koncesionin e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 50% të gjuetisë vjetore të kafshëve të egra të planifikuara sipas numrit të mundshëm të kafshëve të parapara me aktin e themelimit të vendgjuetisë dhe të llogaritura sipas çmimit të tregut.

Neni 31

Kontratat për koncesione

31.1. Në bazë të vendimit për dhënien e koncesionit, lidhet kontrata me shkrim për koncesionin.

31.2. Kontrata për koncesion përveç kushteve tjera të parapara me Ligjin për Koncesione, duket të përmbajë edhe:

- a) pozitën dhe madhësinë e vendgjuetisë e cila ipet në koncesion
- b) përshkrimin e llojit dhe numrit të kafshëve të egra që gjenden në vendgjueti
- c) kërkesën që koncesionari të zbatoj këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas këtij ligji dhe planet menaxhuese.
- d) kërkesën që popullacioni i kafshëve për gjah të jetë në nivel të caktuar në fund të kohëzgjatjes së koncesionit dhe kompensimi i diferencës nëse ajo paraqitet
- e) kohëzgjatjen e koncesionit
- f) formën, lartësinë dhe afatin e pagesës së kompensimit për koncesion
- g) mundësinë dhe arsyet e shkëputjes së parakohshme të kontratës
- h) të drejtat dhe arsyet e ndërprerjes së njëanshme të kontratës.

31.3. Programi i zhvillimit të vendgjuetisë i bashkëngjitet kontratës dhe është pjesë përbërëse e saj.

31.4. Koncesionari është i obliguar që të nxjerr planin afatgjatë menaxhues me vendgjuetinë në afat prej gjashtë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit apo qiras së vendgjuetisë, me pëlqimin e ministrisë.

Neni 32
Shkëputja e parakohshme e kontratës

32.1. Dhënësi i koncesionit mund të shkëpusë kontratën për koncesion para skadimit të afatit nëse koncesionari :

- a) nuk përgatitë Planet menaxhuese ose operacionale,
- b) nuk bënë implementimin e planeve dhe nuk mbanë shënimet lidhur me to,
- c) nuk punëson numër të nevojshëm të rojeve të paraparë me Planin operacional,
- d) nuk bënë përmirësime në vendgjueti të zotuar ose kërkuara si kusht për dhënien e koncesionit, apo ato nuk i bënë me kohë,
- e) nuk jep llogari për të hyrat nga vendgjuetia,
- f) nuk i bën pagesat me kohë,
- g) nuk mundëson inspektimin e planeve, regjistrave dhe dokumenteve përkatëse në kërkesë të autoritetit themelues,
- h) pengon autoritetet kompetente të inspektojnë vendgjuetitë,
- i) nuk i respekton dispozitat e këtij Ligji, ligjeve të tjera përkatëse dhe aktet tjera nënligjore,
- j) nuk përmbushë kushtet tjera të identifikuar si thelbësore në kontratë apo e përdorë vendgjuetinë në kundërshtim me kontratën mbi koncesionin,
- k) nuk i zbaton masat dhe veprimet sipas sipas këtij ligji.

32.2. Kontrata e koncesionit shkëputet sipas ligjit edhe në rastet kur:

- a) Koncesionari është dënuar për shkelje të këtij ligji ose dispozitat e Kodit Penal që kanë të bëjnë me gjuetinë, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim mbi 6 muaj ose dënimi me gjobë prej mbi 1.000 Euro.
- b) kur konstatohet se koncesionari e ka fituar kontratën mbi koncesionin me mashtrim, korrupsion ose veprime tjera ilegale.
- c) Kur vendgjuetia e humbë statusin e vendgjuetisë sipas këtij ligji.

32.3. Kontrata për koncesion duhet të përcaktoj të drejtat dhe obligimet e palëve nëse vend gjuetia zgjerohet ose zvogëlohet gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

32.4. Nëse kontrata për koncesion shkëputet pa fajin e koncesionarit, ai mund të kërkoj kompensim nga qeveria. Vlera e kompensimit nga ky nen mund të jetë deri në vlerën e të ardhurave të pastra që koncesionari do ti realizonte realisht nga menaxhimi me vendgjueti.

Neni 33
Pagesat për koncesione

Pagesat nga koncesioni derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës

Neni 34
Dhënia e vendgjuetive me qira

34.1. Vendgjuetitë e përbashkëta mund të jepen me qira personave fizik dhe juridik, vendor dhe të huaj të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligje dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij, në kohëzgjatje deri në dhjetë vjet.

34.2. Vendgjuetitë e përbashkëta ipen me qira nëpërmes ofertës publike nga Komuna me pëlqimin e ministrisë.

34.3. Për dhënien me qira të vendgjuetisë njoftohet Federata.

34.4. Procedurën e ofertimit për dhënien me qira të vendgjuetisë së përbashkët e zhvillon Komuna në territorin e së cilës gjendet vendgjuetia e përbashkët në bazë të dispozitave të Ofertimi publik.

34.5. Ftesa për ofertë nga ky nen përmban kushtet më të përafërta për dhënien me qira të vendgjuetisë së përbashkët.

34.6. Ofertës i bashkëngjitet dokumentacioni për plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe kushtet e parapara me ofertë.

Neni 35 Çmimi fillestar i qirasë

35.1. Çmimi fillestar për qiranë e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 30% të vlerës së kafshëve të egra të gjuajtura në vitin e pestë të planit të menaxhimit të llogaritura sipas çmimit të tregut.

35.2. Në rastet kur nuk ekziston plani i menaxhimit çmimi fillestar për qiranë e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 50% të gjuetisë vjetore të kafshëve të egra të planifikuara sipas numrit të mundshëm të egërsirave sipas aktit të themelimit të vendgjuetisë të llogaritura sipas çmimit të tregut.

Neni 36 Kontrata për qiranë

36.1. Në bazë të vendimit mbi zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm Komuna dhe ofertuesi lidhin kontratën mbi dhënien me qira të vendgjuetisë së përbashkët. Kontrata lidhet në formë të shkruar dhe përveç tjerash duhet të përmban:

- a) Emërtimin, madhësinë dhe infrastrukturën përcjellëse të vendgjuetisë,
- b) kohëzgjatjen e qirasë;
- c) formën, lartësinë dhe afatin e pagesës së qirasë;
- d) masat të cilat shfrytëzuesi i vendgjuetisë detyrohet t'i ndërmerre me qëllim të zhvillimit të vendgjuetisë;
- e) llojin dhe numrin e përafërt të kafshëve të egra;
- f) të drejtat dhe obligimet tjera të parapara me rregullat e gjuetisë.

36.2. Kontrata nga paragrafi 1 i këtij neni mundet, me kërkesën e qiramarrësit të vazhdohet më së voni në afat prej tre muaj para skadimit të afatit të kontratës për kohën dhe kushtet e njëjta, po që se vërtetohet se qiramarrësi gjatë kohës së menaxhimit të vendgjuetisë me qira iu ka përmbajtur kushteve të kontratës dhe dispozitave ligjore si dhe akteve nënligjore të nxjerrura sipas këtij ligji.

36.3. Kushtet që duhet ti plotësoi qiramarrësi vendgjuetisë përcaktohen me akt nënligjor dhe me kontratën e qirasë.

36.4. Ministria me akt të veçantë e përcakton numrin e kafshëve të egra në vendgjueti.

Neni 37
Shkëputja e parakohshme e kontratës

37.1. Kontrata e qirasë mund të shkëputet para skadimit të afatit për të cilin është lidhë nëse:

- a) qiramarrësi nuk menaxhon vendgjuetinë në harmoni me këtë ligj dhe kontratën mbi dhënien me qira të vendgjuetisë;
- b) për shkak të moszbatimit të masave të parapara me Planin menaxhuese dhe kur fondi i kafshëve të egra ka rënë nënë minimumin e paraparë me Planin menaxhues;
- c) mjetet e realizuara përmes menaxhimit me vendgjuetinë nuk i shfrytëzon për qëllime të parapara sipas këtij ligji.
- d) Nëse sipërfaqja e vendgjuetisë zvogëlohet për më tepër se 20%
- e) Nuk e paguan qiranë në afatin e paraparë me kontratë.

37.2. Në rastet e shkëputjes së parakohshme të kontratës së qirasë së vendgjuetisë gjendjen në vendgjueti dhe zbatimin e Planit menaxhuese e konstaton komisioni profesional i formuar nga themeluesi i vendgjuetisë. Qiramarrësi i deriatëhershëm obligohet që të bënë kompensimin e diferencës negative të kafshëve të egra dhe dëmit eventual të shkaktuar në vendgjueti sipas çmimeve të tregut.

37.3. Përcaktimi i diferencës negative të kafshëve të egra dhe dëmtimit të objekteve teknike dhe të menaxhimit, bëhet me akt nënligjor të nxjerrur nga ministria.

37.4. Në të gjitha rastet e shkëputjes së parakohshme të kontratës së qirasë së vendgjuetisë, zhvillohet procedura e re e ofertimit publik për dhënien e vendgjuetisë në shfrytëzim. Deri në dhënien e vendgjuetisë në shfrytëzim, ndalohet gjuetia e kafshëve të egra ndërsa masat e kultivimit dhe të mbrojtjes së kafshëve të egra i ndërmerren themeluesi i vendgjuetisë apo organi që ai e autorizon.

Neni 38
Pagesa e qirasë

38.1. Mjetet e paguara nga qiraja e vendgjuetive të përbashkëta derdhen në Buxhetin e Komunës në territorin e të cilës është vendgjuetia.

38.2. Afati dhe mënyra e pagesës së qirasë nga ky nen përcaktohet me kontratën mbi dhënien me qira të vendgjuetisë së përbashkët.

Neni 39
Autorizimet dhe përgjegjësitë themelore të menaxhuesve të vendgjuetive

39.1. Menaxhuesit e vendgjuetive:

- a) Caktojnë rregullat e vendgjuetive që janë të arsyeshme dhe të domosdoshme për mbrojtjen e pronës, shëndetit publik dhe sigurisë, dhe që mundësojnë përdorimin e drejtë të vendgjuetisë për gjah, të cilat duhet të jenë në pajtim me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij dhe me rregullat e menaxhimit të qëndrueshëm me kafshë të egra.
- b) Caktojnë kushtet për lejimin e gjuetisë, përfshirë kufizimin e gjuetisë për kohë të caktuara, zona të caktuara, në lloje të caktuara, në kafshë të madhësisë, moshës ose gjinisë së caktuar si dhe të kufizojnë përdorimin e mjeteve dhe metodave të caktuara .

- c) Të caktojnë tarifat e gjuajtjes për personat që lejohen të gjuajnë në vendgjueti.
- d) Të caktojnë tarifa-çmimet për shfrytëzimin e ndërtesave të ndërtuara për funksion të gjuetisë që gjenden në vendgjueti dhe shërbimet në to.
- e) Të organizojnë aktivitete të gjahut dhe të ofrojnë shërbime tjera gjahtarëve.
- f) Menaxhuesi i vendgjuetisë mund të rris numrin e kafshëve për gjah duke lëshuar kafshë në vendgjueti me leje të Ministrisë dhe pasi që Institucioni i autorizuar nga ministria të ketë vërtetuar se ato nuk janë të infektuara nga ndonjë sëmundje ngjitëse dhe me pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.
- g) Me pëlqimin e pronarit të tokës së përfshirë në vendgjueti dhe sigurimin e lejeve përkatëse, menaxhuesi i vendgjuetisë mund të ndërtoj dhe riparoj ndërtesa dhe anekse të ndërtesave për nevoja të gjahtarëve.
- h) Me pëlqimin e pronarit të tokës së përfshirë në vendgjueti menaxhuesi i vendgjuetisë mund të siguroj ushqim, ujë ose strehimore për kafshët e gjahut ose të përmirësoj vendqëndrimet e tyre.
- i) Menaxhuesi i vendgjuetisë është i obliguar të ketë shërbimin profesional ose ekspertin për zbatimin e planit menaxhues të gjuetisë dhe shërbimin e ruajtjes së gjahut.

39.2. Për përparimin e punës së përditshme dhe menaxhimit me vendgjueti, ministria mund të nxjerr akt nënligjor për zgjerimin apo kufizimin e kompetencave të menaxhuesve të vendgjuetive.

Kapitulli V: Planifikimi dhe Inventarizimi

Neni 40

Planifikimi i menaxhimit me kafshë gjahu

Menaxhimi i kafshëve të egra dhe i Vendgjuetive bëhet sipas:

- a) Programit zhvillimor të gjuetisë në Kosovës
- b) Planit menaxhues të vendgjuetive
- c) Planit operativ vjetor

Neni 41

Programi zhvillimor i gjuetisë në Kosovë

41.1. Programi zhvillimor i gjuetisë për Kosovë bëhet për periudhë 10 vjeçare. Ky program hartohet nga Ministria ndërsa aprovet nga Qeveria.

41.2. Ministria duhet ta përgatisë programin e parë zhvillimor brenda dy viteve nga dita e aprovimit të këtij ligji.

41.3. Gjatë përgatitjes së këtij programi Ministria do të konsultohet me ministritë dhe agjencitë tjera përkatëse, nga lëmia e mbrojtjes së natyrës, turizmit, bujqësisë dhe pylltarisë si dhe të kujdeset që Programi të jetë në përputhje me planin hapësinor ekzistues të Kosovës.

Neni 42
Plani menaxhues i vendgjuetisë

- 42.1. Menaxhimi i vendgjuetive bëhet sipas Planeve menaxhuese 10 vjeçare të cilat i hartojnë menaxhuesit e vendgjuetive për çdo vendgjueti që ata menaxhojnë.
- 42.2. Menaxhuesit duhet të përgatisin planin 10-vjeçar menaxhues të vendgjuetive brenda gjashtë muajsh nga dita e lidhjes së kontratës për menaxhim me vendgjueti.
- 42.3. Plani menaxhues i vendgjuetisë duhet të jetë në pajtim me Programin zhvillimor të gjuetisë, planet e menaxhimit me pyje, kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokave bujqësore, bazat hidroekonomike, planet hapësinore, Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe dokumentet ndërkombëtare nga kjo lëmi.
- 42.4. Planet menaxhuese të vendgjuetive me rëndësi të veçantë aprovohen nga ministria ndërsa planet menaxhuese të vendgjuetive të përbashkëta dhe private nga komuna me pëlqimin paraprak të ministrisë.
- 42.5. Nëse subjektet e autorizuar për aprovimin e Planeve menaxhuese nga paragrafi 4 i këtij neni e refuzojnë Planin, menaxhuesi i vendgjuetisë është i obliguar të bëjë përmirësimin e Planit brenda afatit prej 60 ditësh. Nëse subjekti i autorizuar brenda 60 ditësh nuk deklorohet rreth planit apo planin e refuzon pa ofruar shpjegime me shkrim për arsyet pse është refuzuar plani, plani konsiderohet i aprovuar.
- 42.6. Plani menaxhues i vendgjuetisë përmban të gjitha të dhënat për vendgjuetinë, llojin dhe numrin e kafshëve të egra, llojet e mbrojtura, masat e kultivimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit të kafshëve të egra. Plani i shfrytëzimit- gjuetisë duhet të jetë në harmoni me gjendjen numerike dhe strukturën e moshës dhe gjinisë së kafshëve të egra.
- 42.7. Në rast të ndryshimit të përhershëm dhe qenësor të kushteve dhe rrethanave në të cilat bazohet plani menaxhues 10 vjeçar i vendgjuetisë, bëhet revidimi i tij. Revidimi bëhet sipas procedurës së njëjtë që parashihet për nxjerrjen e planit.
- 42.8. Deri në nxjerrjen e planeve 10-vjeçare, menaxhimi i vendgjuetisë do të bëhet me planet operative vjetore.
- 42.9. Përmbajtja, mënyra e dhënies së pëlqimit dhe aprovimit të planeve të menaxhimit të vendgjuetive dhe planeve vjetore të menaxhimit, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrur nga ministria.

Neni 43
Planet vjetore të menaxhimit

- 43.1. Menaxhuesit e vendgjuetive duhet të përgatisin planet vjetore të menaxhimit për çdo vendgjueti që ata e menaxhojnë.
- 43.2. Plani vjetor i menaxhimit duhet të jetë në harmoni me planin 10-vjeçar të menaxhimit me vendgjueti.
- 43.3. Menaxhuesi i vendgjuetisë mund t'i jep leje gjahtarëve për të gjuajtur vetëm nëse është aprovuar plani vjetor i menaxhimit.

43.4. Plani vjetor i menaxhimit për vendgjuetitë me rëndësi të veçantë aprovohet nga ministria ndërsa planet vjetore menaxhuese të vendgjuetive të përbashkëta dhe private nga komuna me pëlqimin paraprak të ministrisë.

43.5. Nëse subjektet e autorizuar për aprovimin e planeve vjetore menaxhuese nga paragrafi 4 i këtij neni e refuzojnë planin vjetor, menaxhuesi i vendgjuetisë është i obliguar të bëjë përmirësimin e planit brenda afatit prej 30 ditësh. Nëse subjekti i autorizuar brenda 30 ditësh nuk deklarohet rreth planit apo planin e refuzon pa ofruar shpjegime me shkrim, plani konsiderohet i aprovuar. Kjo pikë vlen edhe për pëlqimet që kërkohen nga ministria për planet vjetore menaxhuese.

43.6. Menaxhuesit e vendgjuetisë duhet të mbajnë shënime për veprimet që ata i kanë ndërmarr për përmbushjen e planeve vjetore menaxhuese dhe t'i bëjnë raport vjetor themeluesit të vendgjuetisë dhe institucioneve tjera të autorizuara.

43.7. Të gjitha aktivitetet e menaxhimit duhet të jenë në përputhje me planet vjetore menaxhuese të aprovuara. Nëse për shkak të fatkeqësisë natyrore ose rasteve tjera emergjente nuk mund të zbatohet plani vjetor menaxhues, menaxhuesi i vendgjuetisë duhet që sa më shpejtë që është e mundur të njoftoj Ministrinë.

43.8. Pronarët, tokat e të cilëve janë të përfshirë në vendgjueti duhet të lejojnë menaxhuesit e vendgjuetive që në ato toka të ndërmarrin veprimet dhe aktivitetet e parapara në planet vjetore të menaxhimit.

Neni 44

Inventarizimi dhe mbikëqyrja

44.1. Menaxhuesit e vendgjuetive janë të obliguar të grumbullojnë të dhëna për numrin e kafshëve të egra brenda vendgjuetisë dhe të dhëna tjera për gjendjen dhe kushtet e jetesës së kafshëve në vendgjueti.

44.2. Menaxhuesit e vendgjuetive janë të obliguar që shënimet nga paragrafi 1 i këtij neni t'ia dërgojnë ministrisë me kërkesën e saj e cila e mban regjistrin e kafshëve të egra të gjitha vendgjuetive në Kosovë dhe mbikëqyr mbajtjen e numrit dhe kushtet e jetesës së kafshëve.

44.3. Nëse menaxhuesi i vendgjuetisë dështon të ofroj të dhëna për inventarizim ose të dhënat tjera për kushtet e jetesës së kafshëve, ministria mund të mbyll vendgjuetinë derisa menaxhuesi të ofroj të dhënat nga ky nen.

Kapitulli VI: Rojet e gjahut

Neni 45

Punësimi i rojeve

45.1. Menaxhuesit e vendgjuetive janë të obliguar të punësojnë një numër të arsyeshëm të rojeve për të mbrojtur vendgjuetitë nga gjahu i kundërligjshëm dhe dëmtimet tjera të kafshëve të egra.

45.2. Në planet vjetore të menaxhimit, menaxhuesit e vendgjuetive duhet të deklarojnë numrin minimal të rojeve që menaxhuesi ka të punësuar dhe që do të punësoj.

45.3. Rojet e gjahut duhet të mbajnë shenjën e identifikimit dhe uniformën gjersa janë në detyrë.

45.4. Menaxhuesit e vendgjuetive duhet të pajisin rojet e tyre me armë sipas ligjit dhe me mjete të komunikimit me të cilat u mundësohet komunikimi me menaxhuesin dhe policinë për të kërkuar asistencë gjersa janë në detyrë.

Neni 46

Detyrat dhe përgjegjësitë e rojës së gjuetisë

46.1. Roja e gjahut ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) heton shkeljet e mundshme të këtij ligji, akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij ose rregullave të vendgjuetisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse.
- b) ndalon personat që posedojnë pajime për gjueti, qenë të gjahut, kafshë gjahu, ose trofej në ose afër vendgjuetisë, i legjitimon dhe kërkon t'i tregojnë dokumentet që i autorizojnë ata persona të gjuajnë.
- c) ndalon dhe identifikon personat për të cilët roja me arsye dyshon se janë duke bërë shkelje të këtij ligji, akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij ose rregullave të vendgjuetisë.
- d) ndalon dhe kontrollon automjetet dhe mjetet tjera të transportit nëse me arsye dyshon se janë përdorur në shkelje të këtij ligji, akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij ose rregullave të vendgjuetisë.
- e) konfiskon përkohësisht kafshën e gjuajtur, trofetë, dhe pajisjet e gjuetisë për të cilat roja me arsye dyshon se janë përfshirë në shkelje të këtij ligji, akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij ose rregullave të vendgjuetisë dhe ato ia dorëzon policisë.
- f) pengon shkatërrimin e vendbanimeve të kafshëve dhe të vegjëlve të tyre, shtrofullave, çerdheve, dhe vezëve.
- g) vret kafshën e egër të plagosur rënd ose të sëmurë.
- h) lajmëron menjëherë menaxhuesin e vendgjuetisë dhe Shërbimin Veterinar për paraqitjen e ndonjë sëmundje apo ngordhjen e kafshës së egër apo kafshës tjetër dhe për rrezikun e drejtpërdrejtë nga fatkeqësitë elementare.
- i) informon menaxhuesin e vendgjuetisë dhe organin kompetent për gjuetinë të kundërligjshme.

46.2. Përgatitja shkollore, uniforma, shenja identifikuese, lloji i armës dhe formulari i fletëparaqitjes përcaktohen me akt nënligjorë të nxjerr nga ministria.

Kapitulli VII: Trofetë

Neni 47

Vlerësimi i trofeve

47.1. Trofetë e kafshëve të egra të gjahut nga neni 4 i këtij Ligji, konsiderohen brirët, dhëmbët, lëkura, kafka dhe kafsha e balsamuar ose pjesa e sajë.

47.2. Trofetë nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të vlerësohen.

47.3. Vlerësimin e trofeve e bënë komisioni i përbërë nga vlerësuesit e autorizuar të cilët e kanë dhënë provimin për vlerësues të trofeve.

47.4. Provimi për vlerësues të trofeve jepet në Federatë.

47.5. Komisionin për vlerësimin e trofeve të vendgjuetive të veçanta e formon Ministria ndërsa për trofetë e vendgjuetive tjera organi kompetent komunal me propozimin e Federatës.

47.6. Komisionet nga paragrafi paraprak për vlerësimet e trofeve e njoftojnë Federatën e cila mbanë evidencën e trofeve kulminante dhe të jashtëzakonshme.

47.7. Trofetë mund të nxirren nga vendgjuetia apo nga vendi vetëm me listën e trofeve të cilën e lëshon komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni në formularët e përcaktuar, i cili edhe e mbanë evidencën e trofeve të kafshëve të egra dhe fletë trofeve të lëshuara.

47.8. Trofetë kulminante mund të blehen nga Ministria.

47.9. Trofetë kulminante nuk mund të shiten jashtë vendit.

47.10. Përrjashtimisht ministria mund të lejoj shitjen e trofeut kulminant jashtë vendit nëse atë nuk e ka blerë ministria.

47.11. Mënyra e vlerësimit, mbajtjes së evidencës së trofeve, formulari dhe mënyra e lëshuarjës së listës së trofeve dhe e raportimit mbi vlerësimin e trofeve përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga ministria.

Neni 48

Pronësia e kafshëve të vrara dhe trofeve

48.1. Çdo kafshë gjahu e vrarë ose zënë gjatë gjuetisë shkencore nga ky ligj dhe çdo trofe nga kafsha e tillë është pronë e gjahtarit.

48.2. Çdo kafshë gjahu e vrarë ose zënë si lloj dëmtuese mishi dhe trofeu prej një kafshë të tillë është pronë e menaxhuesit të vendgjuetisë nëse është vrarë ose zënë në vendgjueti ndërsa pronë e Ministrisë nëse është vrarë ose zënë jashtë ndonjë vendgjuetisë.

48.3. Çdo kafshë gjahu e vrarë ose zënë gjatë reduktimit apo ndonjë emergjence nga ky ligj dhe mishi e trofeu i kafshës së tillë është pronë e menaxhuesit të vendgjuetisë.

48.4. Ministria me akt nënligjor mund të rregulloj bartjen e kafshëve të egra nga një vend në tjetrin, vënien në qarkullim të kafshëve të egra, inspektimin dhe shitjen e mishit të kafshëve të gjahut të gjuajtura me leje.

48.5. Askush nuk mund të posedoj, shes, blej, ose tregtoj çfarëdo kafshe gjahu vrarë në mënyrë të kundërligjshme ose zënë ose çdo trofeu ose produkti të prodhuar prej një kafshe të tillë.

Kapitulli VIII: Parandalimi dhe kompensimi i dëmeve

Neni 49

Dëmet nga kafshët e egra

49.1. Menaxhuesi i vendëgjuetisë gjegjësisht pronari apo shfrytëzuesi i tokës në të cilën gjendet vendëgjuetia si dhe sipërfaqja e tokës jashtë vendëgjuetisë në të cilat gjinden kafshët e egra detyrohen që të ndër marr masa për pengimin e dëmeve që mund t'i shkaktojnë kafshët e egra pronës dhe njerëzve në vendëgjueti.

49.2. Për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra, menaxhuesi i vendëgjuetisë duhet të ndërmerr këto masa:

- a) të mbajë gjendjen numerike të kafshëve të egra në numër optimal gjegjësisht në kapacitetin e paraparë për vendëgjuetinë;
- b) të siguroj ushqim dhe ujë të mjaftueshëm në vendëgjueti;
- c) pronarët e kulturave bujqësore dhe pyjore në bashkëpunim me menaxhuesin e vendëgjuetisë duhet të zbatojnë masa preventive për mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe pyjore duke përdorur preparate kimike dhe mjete mekanike, frikësuese dhe ngritjen e gardheve.
- d) sigurimi i ushqimit dhe mbjellja e kulturave bujqësore në vendëgjueti me qëllim të mbajtjes së kafshëve të egra larg pronave ku mund të shkaktohen dëme eventuale,

49.3. Ministria me akt të veçantë nënligjor përcakton masat për parandalimin e dëmeve nga kafshët e egra.

Neni 50

Masat për pengimin e dëmit

50.1. Me aktin e themelimit të vendëgjuetisë përcaktohen masat për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra të cilat i ndërmerr menaxheri i vendëgjuetisë, e sidomos:

- a) nxjerrjen e planit vjetor për masat të cilat i ndërmerr për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra (sezonale, llojit të kafshës së egër, llojit të demit nga kafsha e egër, kulturave bujqësore dhe të ngjashme),
- b) furnizimin me mjete mbrojtëse për realizimin e planit vjetor nga paragrafi 1. pika c e këtij neni,
- c) me kërkesën e shfrytëzuesve të tokave, bën shpërndarjen falas të mjeteve të nevojshme mbrojtëse të parapara me planin vjetor dhe ofron udhëzime për përdorimin e tyre.

50.2. Masat nga paragrafit 1 i këtij neni nuk aplikohen për pemishte të rrethuara, plantazhe dhe kultura tjera të ngjashme në pengimin e dëmeve nga kafshët e egra.

Neni 51

Mbrojtja e të lashtave

Po qe se menaxheri i vendëgjuetisë mbanë numër të kafshëve mbi numri e paraparë me Planin menaxhues, detyrohet që me shpenzime të veta dhe me preparate të përshtatshme kimike dhe mjete mekanike t'i mbroj të mbjellurat dhe të lashtat e rrezikuara nga dëmet nga kafshët e egra.

Neni 52

Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve dhe shfrytëzuesve të tokave

52.1. Pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e tokave kanë të drejta dhe obligime:

- a) që me mjete përkatëse të siguruar nga menaxhuesi i vendëgjuetisë dhe të përdorura sipas udhëzimeve të tij, të ndërmarrin masa në mbrojtjen e kopshtijeve, fidanishteve dhe të lashtave të tyre në pengimin e dëmeve nga kafshët e egra,
- b) ta lajmërojnë sa më parë menaxhuesin e vendëgjuetisë mbi rrethanat që mund të ndikojnë në masat e ndërmarrja për parandalimin e dëmeve të cilat mund t'i shkaktojnë kafshët e egra në token e tij, sikurse edhe të dëmeve të sapofilluara,
- c) t'i mundësojnë menaxhuesit që në tokat e tij të ndërmerr masa për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra,
- d) që të largojnë të lashtat bujqësore në afatin e optimal.

52.2. Pronarët përkatësisht shfrytëzuesit e tokave kanë të drejtë të kërkojnë nga organi kompetent i themeluesit të vendëgjuetisë zbatimin e masave për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra nëse menaxhuesi i vendëgjuetisë nuk i ndërmerr masat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 53

Zvogëlimi i numrit të kafshëve të egra

53.1. Me kërkesën e pronarëve apo shfrytëzuesve të tokave, ministria me akt të veçantë nënligjor mund të vendosë të zvogëlohet numri i llojit të caktuar të kafshëve të egra të cilat shkaktojnë dëme të përmasave të mëdha në kultura bujqësore, po qe se masat e parapara me këtë ligj nuk janë treguar mjaft të suksesshme dhe ekonomikisht të arsyeshme.

53.2. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve dhe kafshëve, komunat, menaxhuesit e vendëgjuetive, personat fizik dhe juridik të cilët ushtrojnë veprimtari të bujqësisë dhe pylltarisë janë të obliguar të organizojnë dhe të marrin pjesë në zvogëlimin e numrit të kafshëve të egra në zonat e rrezikuara dhe sjelljen e tyre në numër të arsyeshëm.

53.3. Në vendëgjuetitë dhe sipërfaqet e tokave jashtë saj në të cilat është paraqitur sëmundje ngjitëse apo që mund të paraqitet, menaxhuesi i vendëgjuetisë si dhe personi i cili kujdeset për mbrojtjen e kafshëve të egra është i obliguar të zbatoi masat për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe të lajmëroi Shërbimin Veterinar mbi rrezikun e përhapjes së saj.

Neni 54

Kompensimi i dëmit

54.1. Për dëmin të cilin e shkaktojnë kafshët e egra që mund të gjuhen gjatë sezonës së hapur të gjuetisë, përgjegjës është menaxhuesi i vendëgjuetisë në të cilën kafsha përherë jeton, me kusht që i dëmtuari ka ndërmarrë masat e parapara për pengimin e demit nga kafsha e egër, të cilat ka qenë i detyruar ti ndërmarrë në harmoni me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij.

54.2. Kafshët e gjahut që gjinden në ose afër vendgjuetisë ku është bërë dëmi, konsiderohen se jetojnë përherë në atë vendgjueti, përveç nëse menaxhuesi i vendgjuetisë e vërteton të kundërtën.

54.3. Nëse Qeveria apo ndonjë ministri përkatëse përkohësisht ose përherë e ndalon gjuetinë e kafshëve të gjahut, atëherë ajo është përgjegjëse për dëmet që i shkaktojnë kafshët e gjahut. Ndalimi i gjuajtjes së kafshëve të gjahut nuk përfshinë caktimin e sezonës së hapur për kafshët nga neni 8.

54.4. Personat të cilët kullojnë bagëtinë në kullostat për të cilat nuk posedojnë leje për kullotje apo nuk paguajnë taksën e caktuar për kullosë si dhe personat të cilët gjuajnë në mënyrë të kundërligjshme nuk kanë të drejtë në kompensim të demit të shkaktuar nga kafshët e egra gjatë gjuetisë.

Neni 55

Dëmet në kafshët e egra

55.1. Për mbrojtjen e kafshëve të egra në vendgjueti, menaxhuesi i vendgjuetisë ndërmerr këto masa:

- a) mbrojtja me ndalesën e gjuetisë të llojeve të caktuara të kafshëve të egra gjatë tërë vitit;
- b) mbrojtja me ndalesën e gjuetisë gjatë sezonit të gjuetisë të llojeve të caktuara;
- c) mbrojtja e kafshëve të egra në rast të fatkeqësive elementare (zjarri ,vërshimi, bora, thatësia e madhe, etj.);
- d) mbrojtja nga sëmundjet e kafshëve në vendgjueti;
- e) evidentimi i kafshëve të sëmura dhe ndërmarrja e masave për kontrollim nga veterinarit;
- f) ndërmarrja e masave në sanimin e gjendjes numerike të kafshëve të egra, nëpërmes zvogëlimit të gjuetisë deri sa të arrihet numri i duhur i tyre në vendgjueti;
- g) pengimi i gjuetisë së kundërligjshme, mbrojtja e të vegjëlve dhe pengimi i përdorimit të preparateve të helmimit si dhe veprimet të tjera të pa lejuara sipas këtij ligji.
- h) në rrugë, në vendet ku mund të kalojnë kafshët e egra i propozon Organit kompetent vendosjen e shenjave të komunikacionit dhe të kufizimit e shpejtësisë.

55.2. Personat juridik apo fizik të cilët gjuajnë kafshë të egra në kundërshtim me këtë ligj apo në mënyrë tjetër i shkaktojnë dëme vendgjuetisë detyrohen që dëmin e shkaktuar t'ia kompensojnë menaxhuesit të vendgjuetisë.

55.3. Vlerësimi i demit bëhet nga Komisioni për vlerësimin e demit i cili formohet për vendgjuetitë me rëndësi të veçantë, nga ministria ndërsa për vendgjuetitë tjera, nga Komuna.

55.4. Kompensimi i demit bëhet me marrëveshje në mes të menaxhuesit të vendgjuetisë dhe personit i cili ka shkaktuar dëmin. Po qe se në afat prej 30 ditëve nuk arrihet marrëveshja për kompensim të demit menaxhuesi i vendgjuetisë kompensimin e demit e realizon përmes gjykatës në procedurë të rregullt gjyqësore.

55.5. Ministria me akt nënligjor cakton listën e çmimeve gjegjësisht vlerën e kafshëve të gjahut sipas së cilës bëhet kompensimi, procedurën e kompensimit si dhe përbërjen e komisioneve për vlerësimin e dëmeve.

Neni 56
Qentë dhe Macat

56.1. Pronarët e qenve nuk mund t'i lëshojnë qentë të bredhin të pakontrolluara në vendgjueti.

56.2. Pronarët e kafshëve bujqësore mund t'i përdorin qentë e tyre në vendgjueti për të mbrojtur dhe kontrolluar kafshët e tyre, por numri i qenve nuk duhet të jetë më i madh se që është e nevojshme për mbrojtje dhe kontroll efektive, dhe qentë duhet të jenë nën kontroll të bariut.

56.3. Pronarët e qenve dhe macave janë përgjegjës për dëmet që qentë dhe macat e tyre i shkaktojnë në kafshët e gjahut në vendgjueti.

56.4. Ministria me akt nënligjor mund të autorizoj menaxhuesit e vendgjuetive të kontrollojnë qentë dhe macat endacake në vendgjueti.

Kapitulli IX – Mbikëqyrja dhe Inspektimi

Neni 57
Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij e bën ministria përmes Inspektorëve të gjuetisë dhe organeve tjera të autorizuar.

Neni 58
Autorizimet dhe detyrat e Inspektorit të gjuetisë

58.1. Inspektori i gjuetisë është i autorizuar dhe ka për detyrë të:

- a) kontrollon vengjuetinë, objektet menaxhuese dhe teknike dhe kushtet tjera të përcaktuara të vendgjuetisë të cilat menaxhuesi është i obliguar t'i plotësoi për të menaxhuar me vendgjuetinë, si dhe mënyrën e shënimit të kufijve të vendgjuetisë;
- b) kontrollon zbatimin e Planit menaxhues dhe planeve operationale vjetore të menaxhimit me vendgjuetitë;
- c) kontrollon librat afariste dhe dokumentacionin tjetër kur paraqitet nevoja me qëllim të shikimit të shfrytëzimit të mjeteve, zbatimin e rregullave dhe masave të cilat kanë të bëjnë me kafshët e egra dhe me vendgjuetitë;
- d) kontrollon gjuajtjen e kafshëve të egra, lejen për gjuajtjen e kafshëve të egra, fletpërcjelljet dhe listat e trofeve për kafshën e egër të gjuajtur;
- e) kontrollon përdorimin e armëve dhe municionit të përshtatshëm për gjueti;
- f) kontrollon zbatimin e masave për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra dhe urdhëron masat e përkohshme për pengimin e dëmeve në kafshë të egra;
- g) bën kontrollin e masave të ndalimit nga neni 9 i këtij ligji;
- h) kontrollon punëtorit e personave që bëjnë balsamimin e kafshëve;

i) përkohësisht ndalon të gjitha veprimet të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura në bazë të tij;

j) përkohësisht konfiskon kafshën e egër të gjuajtur në mënyrë të kundërligjshme dhe pjesët e saja, ndalon vënien në qarkullim ose përvetësimin e pa ligjshëm të kafshës së mbytur dhe pjesëve të saja si dhe mjetet dhe pajisjet me të cilat është kryer veprimi i dyshuar, deri në Vendimin përfundimtarë të organit kompetent;

k) urdhëron masat për pengimin e dëmeve në rastet urgjente në të cilat mund të shkaktohen dëme me përmasa me interes të përgjithshëm;

l) i njofton organet kompetente për pa rregullsitë e konstatuara dhe marrjen e masave për evitimin e tyre.

58.2. Të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët i nënshtrohen inspektimit janë të obliguar që inspektorit të gjuetisë t'i mundësojnë inspektimin e papenguar dhe ti ofrojnë të gjitha shënimet e kërkuara.

Neni 59

Marrja e masave

59.1. Po qe se Inspektori i gjuetisë në procedurën e inspektimit vërteton se janë shkelur dispozitat e këtij ligji apo akteve të nxjerrura në bazë të tij, me Aktvendim urdhëron evitimin e pa rregullsive dhe mangësive brenda afatit të caktuar.

59.2. Kundër Aktvendimit të Inspektorit të gjuetisë mundë të ushtrohet ankesë ministrisë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit.

59.3. Ankesa e ushtruar kundër Aktvendimit nuk e pengon ekzekutimin.

59.4. Nëse Inspektori i gjuetisë, gjatë inspektimit konstaton se shkelja paraqet kundërvajtje apo vepër penale, është i detyruar të ushtroi kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse përkatësisht fletëparaqitje për inicimin e procedurës penale.

Neni 60

Kualifikimi i Inspektorëve të gjuetisë dhe identifikimi

60.1. Punët e Inspektorit të gjuetisë mundet t'i ushtroi personi i cili ka të kryer Fakultetin e pylltarisë, veterinarisë gjegjësisht Fakultetin e bujqësisë drejtimi i blegtorisë ose Fakulteti i biologjisë dhe provimin profesional për Inspektor të gjuetisë me së paku 3 vjet përvojë të punës në lëmi.

60.2. Programin për pjesën e posaçme të provimit profesional nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministria.

60.3. Inspektori i gjuetisë pajiset me dokument zyrtarë të identifikimit. Formën dhe përmbajtjen e dokumentit zyrtarë të identifikimit e përcakton ministria.

Kapitulli X: Dispozitat ndëshkimore

Neni 61

Dënimet

61.1. Me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 deri 10.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi nëse:

- a) lejon gjuajtjen apo gjuan kafshe të egra jashtë sezonit të hapur për gjueti (neni 8. paragrafi 6, 7.);
- b) organizon apo lejon gjuajtjen e kafshëve të egra ose gjuan kafshë të egra me teknika dhe mjete të ndaluara për gjueti (neni 9);
- c) kultivon kafshë të egra në numër i cili nuk është në harmoni me ekuilibrin biologjik të vendgjetisë (neni 14 paragrafi 1);
- d) gjuan kafshët e egra në vendet e ndaluara për gjueti (neni 24);
- e) e jep të drejtën e gjuetisë në vendgjueti apo në pjesën e saj me nën qira në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji (nenit 34. paragrafi 6);
- f) ngritë apo riparon anekse për nevoja të gjahtarëve në kundërshtim me këtë Ligj (neni 39.1 pika g);
- g) nuk e ka të organizuar shërbimin e rojës së gjuetisë dhe numër të punësuarve të paraparë me Planin operativ (neni 39.1 pika (i) dhe neni 45);
- h) organizon apo lejon gjuajtjen e kafshëve të egra pa Program zhvillimor dhe pa Planet menaxhuese (neni 40);
- i) nuk i zbaton Planet dhe Programet e menaxhimit me kafshë të egra (neni 41,42 dhe 43);
- j) nuk e zbaton revidimin e Planit menaxhues në rastet e parapara me ligj (neni 42 paragrafi 7);
- k) nuk ofron mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe të mbjellurave tjera për shkak të numrit të kafshëve të egra mbi numrin e paraparë me Planin menaxhues (neni 51);
- l) nuk e njofton Shërbimin Veterinar kur kupton se te kafshët e egra në vendgjueti dhe jashtë saj është paraqitur apo mund të paraqitet sëmundja ngjitëse dhe nuk ndërmerr masat e duhura për pengimin e paraqitjes së saj (neni 53. paragrafi 3);
- m) nuk ndërmerr masa për pengimin e gjuetisë së kundërligjshme, mbrojtjes së të vegjëlve të tyre dhe veprime të tjera (neni 55 paragrafi 1).

61.2. Me dënim me gjobë në shumë prej 500 deri 5.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi nëse:

- a) përdor helm për vrasjen e kafshës së egër brenda vendgjuetisë pa e informuar menaxhuesin e vendgjuetisë ose gjuan kafshë të egra gjatë natës (neni 9 paragrafi 2 dhe 4);
- b) lejon përdorimin e gjahut grupor për vrasjen ose zënien e kafshëve thundrore përveç derrave të egër (neni 9 paragrafi 6);

- c) lejon që qentë të mundojnë ose sulmojnë kafshën e plagosur (neni 9 paragrafi 7);
- d) lejon ose gjuan kafshë të egra me pushkë ose municion të gjuetisë të cilat nuk janë të lejuara dhe nuk i përgjigjen fuqisë ose rezistencës së llojit të caktuar të kafshës, apo me armë ose municion të ndaluar për gjueti (neni 10. paragrafi 1);
- e) lejon gjuajtjen e kafshëve të egra personit i cili nuk i plotëson kushtet për gjueti apo nëse merret me gjueti pa qen i kualifikuar për gjahtar (neni 11 paragrafi 1);
- f) vret kafshën e egër dëmtuese pa e informuar policinë dhe pa lejen e menaxhuesit të vendgjuetisë (neni 13 paragrafi 3 dhe 5);
- g) në vendgjueti sjellë lloje të reja të kafshëve të egra me të cilat vjen deri të rritja e numrit të kafshëve të egra, pa lejen e ministrisë (neni 39.1 pika (f));
- h) bartë, mundëson apo lejon bartjen e trofeve të kafshëve të egra nga vendgjuetia ose nga vendi pa listën dhe formularin e trofeve (neni 47 paragrafi 7);
- i) nuk ndërmerr masat e duhura për pengimin e dëmeve nga kafshët e egra (neni 49);
- j) nuk organizon apo nuk merr pjesë në zvogëlimin e numrit të kafshëve të egra në zonat e rrezikuara dhe sjelljen e tyre në numër të arsyeshëm (neni 53 paragrafi 2).

61.3. Me dënim me gjobë në shumë prej 200 deri 2.000 €do të dënohet për kundërvajtje personi nëse:

- a) nuk mundëson në vendgjueti gjuetinë për qëllime shkencore apo e mundëson pa leje për gjah nga ministria apo nëse gjuan për qëllime shkencore pa lejet e nevojshme (neni 12);
- b) nuk e bën shënimin dhe mirëmbajtjen e kufijve të vendgjuetisë (neni 25);
- c) nëse nuk ndërmerr masat e nevojshme për parandalimin e dëmeve ndaj kafshëve të egra dhe nuk tregon kujdes gjatë përdorimit të preparateve kimike, korrijeve dhe kositjeve (neni 23 paragrafi 1 dhe 2);
- d) i shkatërron apo dëmton objektet në vendgjueti ose merr, dëmton, lëviz ose shkatërron shenjat e kufijve administrative të vendgjuetive (neni 39 pika 1/d dhe neni 25 paragrafi 3);
- e) nuk e bën vlerësimin e trofeve dhe nuk mban evidencën e tyre (neni 47);
- f) nëse shet, blen apo tregon çfarëdo kafshe gjahu të vvarë apo të zënë në mënyrë të kundërligjshme ose çfarëdo trofe ose produkt të prodhuar prej kafshës së gjuajtur (neni 48 paragrafi 5);
- g) lejon që qentë të bredhin në vendgjueti të pa kontrolluar (neni 56 paragrafi 1 dhe 2);
- h) pengon inspektorin e gjuetisë në kryerjen e mbikëqytjes apo nuk i ofron shënimet e kërkuara (neni 58 paragrafi 2);
- i) nuk vepron sipas vendimit të inspektorit të gjuetisë dhe urdhrave të rojës së gjahut (neni 59 paragrafi 1 dhe neni 46);

Neni 62
Masat mbrojtëse

Përveç dënimit për kundërvajtje nga neni 61 personit mund t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të mjetit-sendit që është përdorë apo është destinuar për kryerjen e kundërvajtjes si dhe masa mbrojtëse e konfiskimit të pasurisë së arritur si rezultat i kundërvajtjes apo që ka mbetur si rezultat i kryerjes së kundërvajtjes.

Kapitulli XI: Dispozitat Përfundimtare
Neni 63

63.1. Të gjitha vendgjuetitë e themeluara sipas ligjeve të mëparshme mbesin në fuqi deri në themelimin e vendgjuetive sipas këtij ligji.

63.2. Personi që menaxhon me vendgjueti sipas ligjeve paraprake, vazhdon të menaxhoj atë deri në dhënien e vendgjuetive në menaxhim sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj.

63.3. Caktimi i vendgjuetive me rëndësi të veçantë dhe vendgjuetive të përbashkëta si dhe dhënia e tyre në menaxhim duhet të bëhet në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

63.4. Planet ekzistuese menaxhuese dhe operationale të vendgjuetisë mbesin në fuqi deri në themelimin dhe dhënien në menaxhim të vendgjuetive sipas dispozitave të këtij ligji.

63.5. Personat të cilët e kanë të dhënë provimin për gjahtar para aprovimit të këtij ligji, konsiderohen si gjahtar i kualifikuar.

Neni 64
Ligji i zbatueshëm

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Gjuetinë (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 37 e dt. 05 tetor 1979) si dhe dispozitat e ligjeve tjera të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 65
Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përhershëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr. 02/L-53
16 dhjetor 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci